



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 983/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik G.I.Srpska, dega në Ranilug, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Narodna Partia Kosova (SNPK), dega në Ranilug, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e G.I.Srpska dega në Ranilug.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga G.I.Srpska dega në Ranilug, në të cilën ka pretenduar se me dt 30.11.2013 rreth orës 03.30, në mëngjes Jovica Stanković së bashku me Stefan Krstić dhe Boban Filipović, duke u kthyer në shtëpi nga një lokal, kanë gjetur fotografimin e kandidatit të G.I Srpska, Gradimir Mikić dhe kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, dhe këto afishe janë hedhur gjatë heshtjes zgjedhore, dhe kështu mendojnë që është shkelur ligji për zgjedhje dhe për këto e kanë lajmëruar edhe policinë, dhe kërkojnë nga organet kompetente që të reagojnë lidhur me këtë rast. Të bashkangjitur e ka edhe një fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshme pretendimet ankimore të ankuesit G.I Srpska ndaj subjektit politik SNPK. Mirëpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që nuk janë të përgjithshme dhe janë të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 983/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.